



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority



*Konkurrenca është e mirë,
e rregulluar është më e mirë*

RAPORTI VJETOR 2021



TË DHËNAT E PUBLIKUARA

Publikuar nga:

AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS

Adresa:

Ndërtesa e ish "Bankës së Lubjanës", kati VI

Rruga "Migjeni", pn. Prishtinë

Tel: 038 200 109 82

Web: <http://ak.rks-gov.net>

1

Mars 2022

Përmbajtja

FJALA HYRËSE	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
KORNIZA LIGJORE	7
PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	9
FUSHËVEPRIMI QË MBULON INSTITUCIONI	10
RASTET E TRAJTUARA PËR PERIUDHËN RAPORTUESE	12
marrëveshjet e ndaluara	12
Pozita Dominuese	14
Mendimet Profesionale.....	16
Divizioni i Analizës, Metodologjisë dhe të Drejtave Ekskluzive	19
Përqendrimet e ndërmarrjeve në treg.....	21
Tregjet e monitoruara	23
AKTIVITETE TJERA	27
ANKESAT DHE KËRKESAT E OPERATORËVE EKONOMIK	27
BASHKËPUNIMI RAJONAL DHE NDËRKOMBËTAR	29
• BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR.....	31
Përfaqësimet, ankesat dhe kërkesat në gjykata	32
Përfaqësime, përgjigje në padi, aktgjykime, ankesa	32
Trajnimet e brendshme, vizitat jashtë shtetit, konferencat dhe seminarët on-line ..	33
RAPORTI FINANCIAR	38
RAPORTI VJETOR DHE REKOMANDIMET E ZKA.....	39
SFIDAT DHE REKOMANDIMET E INSTITUCIONIT	40
SHTOJCAT	42

FJALA HYRËSE

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: AKK), në zbatim të Ligjit Nr. 03/L-229 për mbrojtjen e Konkurrencës, ia dorëzon Kuvendit të Republikës së Kosovës Raportin Vjetor (në tekstin e mëtejshëm: Raporti), për punën e AKK-së për vitin 2021, në afatin ligjor siç është përcaktuar në Nenin 28 (***citoj: pg 1.13. harton raportin vjetor për punën e Autoritetit dhe të njëjtin ia paraqet Kuvendit të Kosovës më së largu deri me 31 mars të vitit vijues***). Përgatitja dhe dorëzimi i Raportit është përgjegjësi e Komisionit të Konkurrencës (Neni 28-Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit). Në mungesë të Komisionit të Konkurrencës, Raporti dorëzohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të AKK-së.

Raporti është përgatitur për të informuar Deputetet e Kuvendit të Kosovës, përmes Komisionit për Ekonomi si dhe opinionin publik, ekonomik, profesional dhe publikun e gjerë për aktivitetet në vitin 2021 dhe në këtë mënyrë të garantojë transparencën e punës së AKK-së dhe të kontribuojë më tej në afirmimin e konkurrencës efektive dhe ndalimin e praktikave të padrejta tregtare.

Sikur në vitin 2020, edhe vitin 2021 e ka shoqëruar vështirësia e shkaktuar nga Pandemia COVID-19, me mbyllje të herëpashershme dhe kufizime në punën e stafit të AKK-së dhe kufizime në punën e bizneseve. Ligji i konkurrencës ka dëshmuar të jetë një mjet fleksibël në këtë situatë të jashtëzakonshme. Në shumë sektorë ndërmarrjet duheshin të bashkëpunonin me njëra-tjetrën për të reaguar ndaj ngushticave në prodhimin, magazinimin, logjistikën dhe shpërndarjen e mallrave.

Në kushtet e tilla, me kufizime dhe ndërprerje të aktiviteteve biznesore, edhe sjelljet dhe qasja e bizneseve ka krijuar situata në dukje përmes bashkëpunimeve me njëri-tjetrin ose të koordinojnë nga afër aktivitetin e biznesit me furnitorët e tyre që në rrethana normale do të ishte problematike sipas Ligjit të Konkurrencës. Në vazhdimësi kemi përcjell qasjen e Autoriteteve të Konkurrencës të rajonit dhe logjikën e ndjekur nga Komisioni Evropian dhe autoritetet tjera brenda Evropës, duke marr parasysh qasjen e tyre në vlerësimin e sjelljeve anti-konkurruese. Në mënyrë të shpejtë dhe jo-burokratike ne kemi luajtur një rol pro aktiv, avokues dhe shumë bashkëpunues me ndërmarrje të ndryshme për t'ia lehtësuar atyre veprimtarinë ekonomike.

Bashkëpunimi me ndërmarrjet e ndryshme ishte në nivel të kënaqshëm, dhe preventimi i kartelevë apo abuzimeve me pozitën dominuese në tregje të caktuara ishte në nivel, marrë për

bazë kushtet e jashtëzakonshme që po kalonte ekonomia e Kosovës, bizneset e sajë dhe qytetarët në përgjithësi.

Avokimi me akterë të ndryshëm të shoqërisë doli të ishte instrumenti më i suksesshëm gjatë pandemisë. Ne arritëm që në masë të konsiderueshme të përçojmë informatën e duhur dhe të saktë tek qytetarët tanë, dhe ta eliminojmë panikun e ngritur, sidomos në aspektin e mungesës së produkteve bazë ushqimore me qëllim parandalimin e krijimit të rezervave të panevojshme për qytetarët dhe efektet në ngritjen e çmimeve të tepruara apo (Price gouging), në shumë produkte. Në kuadër të instrumentit të Avokimit, bashkëpunimi me medie dhe shoqërinë civile, pjesëmarrja në tryeza dhe debate mediale ishte i shtuar.

Në fushën e hetimeve, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës gjatë vitit 2021 ka trajtuar disa raste të ndjeshme. Gjithashtu, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) ka filluar procedurë hetimore ndaj ndërmarrjeve KEDS dhe KESCO, të cilat operojnë në tregun e energjisë elektrike. Hetimi ndaj këtyre ndërmarrjeve është autorizuar nga Komisioni i AKK-së dhe vjen si rezultat i një studimi të detajuar të tregut të energjisë në Kosovë.

Vendimet tjera janë të elaboruara në mënyrë të detajuar në këtë raport.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në përputhje me detyrimin ligjor, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) raporton çdo vit në Kuvendin e Kosovës. Raporti Vjetor për vitin 2021 përshkruan aktivitetet e AKK-së dhe informon institucionet përkatëse, operatorët ekonomikë dhe të gjithë akterët profesionistë rreth funksionimit të AKK-së, duke i siguruar lidhur me transparencën e punës së tij dhe ndërgjegjësimin e ngritur për kulturën e konkurrencës në Republikën e Kosovës.

Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i AKK-së janë përcaktuar në Statutin e tij, i cili është miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës. Komisioni i AKK-së është organ kolegjal që menaxhon me punën e Autoritetit, përbëhet nga pesë (5) anëtarë, njeri prej të cilëve është kryetar i Komisionit.

Kryetari i Komisionit udhëheq organizon dhe drejton punën dhe veprimtarinë e Autoritetit dhe është përgjegjës për punën profesionale të Autoritetit.

Komisioni miraton vendimet e tij në mbledhjet e tij, me shumicën e votave, ku asnjë anëtar i Komisionit nuk mund të abstenojë nga votimi. Vendimet mund të merren vetëm nëse në seancë janë të pranishëm kryetari ose zëvendëskryetari i Komisionit dhe së paku dy anëtarë të tjerë të tij.

Fushëveprimi i AKK-së konform Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës trajton tri (3) shtyllat kryesore të keqpërdorimit apo shtrembërimit të konkurrencës: 1. Marrëveshjet e ndaluara – Kartelet, 2. Abuzimi me Pozitën Dominuese, 3. Përqendrimet apo bashkimet e palejuara.

Gjatë pandemisë, AKK ka zhvilluar aktivitete proaktive, duke avokuar, parandaluar dhe sensibilizuar opinion e gjithmbarshëm rreth panikës së krijuar nga qytetarët në aspektin e furnizimit me artikuj bazik ushqimor (siç është mielli, kripa, vaji, sheqeri, orizi) dhe artikuj higjienik.

Numri i ankesave të qytetarëve gjatë vitit 2021 ka rënë edhe si rezultatet e përshtatjes në kushtet e Pandemisë të operatorëve ekonomik, ngopjes së tregut dhe angazhimeve Institucionale dhe mediale. Ankesat janë trajtuar me kujdes dhe profesionalizëm, janë dhënë përgjigje meritore secilës ankesë.

Pas vendimit të Bordit për Licencim të Institucioneve Private Shëndetësore për lejimin e shërbimeve të testimeve për SARS-Cov19, në vitin 2020, ka qenë një dakordim me Ministrinë e Shëndetësisë, që ky proces të monitorohet dhe zhvillohet duke respektuar politikat e konkurrencës. Autoriteti ka marrë zotime, që të monitorojë sjelljen e këtyre institucioneve lidhur me caktimin e çmimeve të këtij shërbimi, si dhe t’iu bëjmë me dije institucioneve të licencuara se ky proces do të monitorohet nga autoritetet shtetërore. Ky aktivitet ka vazhduar edhe në pjesën e parë të vitit 2022.

Përveç aktiviteteve për zbatimin e rregullave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, AKK gjithashtu ka qenë në mënyrë aktive e përfshirë edhe në promovimin e kulturës së konkurrencës në vend.

Në kuadër të aktiviteteve primare në fushën e konkurrencës në vitin 2020, AKK ka trajtuar shtatëmbëdhjetë raste (17) raste, ka monitoruar tetë (8) tregje (tregu i çimentos, tregu për produktet grurë, miell, gaz, naftë, benzinë, sheqer, vaj dhe transport, Monitorimi në tregun e shitjeve me pakicë, Sektori i Shëndetësisë – Laboratorët e licencuar për testim SARS-COV19, Monitorimi i sektorit të Radio – Taksive, Monitorimi i produktit të vajit të Lulediellit, Monitorimi i berberëve në Komunën e Kaçanikut, Rahovecit, Mitrovicës dhe Pejës, Monitorimi i sektorit të gastronomisë në Komunën e Prishtinës, Mitrovicës dhe Gjilanit) dhe ka zhvilluar dy (2) analiza të tregjeve (Sektori financiar dhe bankar dhe i shëndetësisë).

Periodha e raportimit dhe sidomos pjesa e parë e vitit 2021 shënoi një aktivitet në rritje të AAK-së në fushën e legjislacionit përmes grupit punues për hartimin e Ligjit të ri për mbrojtjen e konkurrencës si dhe angazhimet e eksperteve në përafrimin e Draft ligjit me rregullat e BE-së dhe për hartimin e legjislacionit sekondar, i cili është një rezultat i drejtpërdrejtë i konsolidimit të Autoritetit dhe forcimit të rolit të tij rregullativ. Në fund të vitit 2021 ky projektligj është miratuar nga Qeveria dhe në lexim të parë edhe nga Kuvendi i Kosovës.

Të gjeturat kryesore të monitorimit të tregut nga ana e AKK-së publikohen rregullisht në përputhje me politikën e saj të transparencës dhe me qëllim të promovimit të efekteve të vendimeve, opinioneve dhe veprimtarive të tjera brenda komunitetit të biznesit, konsumatorëve, autoriteteve të administratës publike, akademikëve, ekspertëve dhe publikut të gjerë.

Promovimi i politikave të konkurrencës si shtyllë e rëndësishme e Ligjit, është një domosdoshmëri e punës së përditshme të AKK-së. Si rrjedhojë, gjatë vitit 2021, AKK ka arritur të nënshkruaj Memorandum të Mirëkuptimit me Administratën Tatimore të Kosovës dhe me dy Institucione universitare private në Kosovë, Kolegjin UBT dhe Kolegjin AAB.

Mbështetja e projektit e financuar nga Komisionit Evropian për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës është një komponent e rëndësishme në avancimin profesional të institucionit. Projekti ka luajtur një rol të veçantë në këtë drejtim, duke i ofruar stafit të AKK-së trajnime themelore dhe të avancuara në fushën dhe politikat e konkurrencës. Projekti njëherazi ka ofruar mendime dhe opinione, menaxhmentit rreth hartimit të metodologjive studiuese të tregjeve, metodave investigative dhe grumbullimin e fakteve.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është përfitues i projektit IPA2017, Projekti i financuar nga BE-ja *“Mbështetje e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin e Ndihmës Shtetërore”*, me vlerë të kontratës prej 2,998,000 €, që ka filluar punën në Prishtinë më 15 janar 2019. Projekti zbatohet nga një konsorcium i udhëhequr nga B&S Europe dhe duke përfshirë Këshillin e Konkurrencës së Republikës së Lituanisë, Kosovo Legal Services Company LLC dhe firma italiane Archidata. Projekti do të zgjasë deri më 15 maj 2022.

KORNIZA LIGJORE

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është i ngarkuar për zbatimin e këtyre akteve ligjore dhe nën ligjore, e të cilat janë:

Ligjet	1. Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës; 2. Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës; 3. Ligji nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative
Statuti	1. Statuti i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës Nr. 04-V-312
Udhëzimet Administrative	1. Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 për formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit; 2. Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2012 për kriteret dhe kushtet për caktimin e marrëveshjeve me vlerë të vogël; 3. Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2012 për mënyrën e paraqitjes së kërkesës dhe kriteret për konstatimin e përqendrimit të ndërmarrjeve; 4. Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2012 mbi kriteret për lirin ose uljen e masës administrative; 5. Udhëzim Administrativ Nr. 02-2017 për përjashtimin grupor të marrëveshjeve horizontale; 6. Udhëzim Administrativ Nr.03-2017 mbi përjashtimet grupore të marrëveshjeve vertikale të ndërmarrësve; 7. Udhëzim Administrativ Nr. 04-2017 për përjashtimet grupore të marrëveshjeve në sektorin e transportit; 8. Udhëzim administrativ Nr. 05-2017 për përjashtimet grupore të marrëveshjeve në sektorin e sigurimeve 9. Udhëzim Administrativ Nr. 06-2017 për përjashtimin grupor të marrëveshjes për d.s.a.m. 10. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2018 mbi kriteret për shqiptimin e masës së sanksioneve administrative; 11. Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2018 mbi mënyrën dhe kriteret për konstatimin e tregut përkatës – relevant;
Rregulloret	1. Rregullore Nr. 04/2018 e punës së Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës; 2. Rregullore nr. 03/2018 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës 3. Rregullore Nr.01-2017 për procedurën hetimore të AKK-së; 4. Rregullore nr. 02/2019 për kategoritë e marrëveshjeve të specializimit 5. Rregullore nr. 01/2019 për disa kategori të marrëveshjeve të kërkimit dhe zhvillimi
	1. MOU me Republikën e Shqipërisë 2. MOU me Republikën e Maqedonisë së Veriut

Memorandumet me Shtete	3. MOU me Republikën e Kroacisë 4. MOU me Republikën e Turqisë 5. MOU me Republikën e Bullgarisë 6. MOU me Republikën e Austrisë
Memorandumet e brendshme	1. MOU me Policinë e Kosovës 2. MOU me Zyrën Rregullatore të Energjisë 3. MoU me Administratën Tatimore e Kosoves 4. MoU Kolegjin UBT 5. MoU me Kolegjin AAB

		
Memorandum bashkëpunimi lidhur në mes të Autoritetit të Konkurrencës dhe Kolegjit UBT me dt. 19.02.2021	Memorandum bashkëpunimi i lidhur në mes të Autoritetit të Konkurrencës dhe Kolegjit AAB me dt. 28.01.2021	Memorandum bashkëpunimi lidhur në mes Autoritetit të Konkurrencës dhe Administratës Tatimore të Kosovës me dt. 11.02.2021

Në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Komisioni i AKK-se ka hartuar draft Ligjin e Ri për Mbrojtjen e Konkurrencës i cili pritet të aprovohet në kuvend gjatë vitit 2022.

PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT



Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 7 Nëntor 2008, në bazë të Ligjit Nr. 2004/36 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Autoriteti është person juridik me autorizime publike, i financuar nga Buxheti Kosoves, i cili në mënyrë të pavarur i kryen punët duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe në dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Qëllimi i mbrojtjes së konkurrencës është para së gjithash krijimi i përfitimeve për konsumatorët dhe krijimi i kushteve të barabarta për të gjitha bizneset në treg, të cilat duke u sjellur në pajtim me rregullat ekzistuese dhe duke garuar në treg me cilësitë, çmimet dhe inovacionet e produkteve dhe shërbimeve të tyre, i kontribuojnë zhvillimit të përgjithshëm të ekonomisë.

Kur kemi të bëjmë me ndërmarrësit dhe sjelljet e tyre antikonkurrese, si për shembull lidhja e Marrëveshjeve me konkurrentët për çmimet, abuzimi me pozitën dominuese ose kontrolli i përqendrimeve/bashkimi ndërmarrësve, Autoriteti e bënë vlerësimin e sjelljeve të tilla, në rast të keqpërdorimit të pozitës dominuese, i ndëshkon shkelësit e rregullave dhe ju dërgon mesazhe unike të gjithë pjesëmarrësëve në treg. Pra iniciativat e lira të ndërmarrësve nuk guxojnë të kufizohen, por zhvillimi i tyre kryhet sipas rregullave rigorozë të konkurrencës në treg, të cilat nuk janë represive, por parandaluese.

Një nga detyrat më të rëndësishme të Autoritetit është promovimi i kulturës së konkurrencës dhe hetimi i veprimeve të ndërmarrjeve të cilat shtrembërojnë dhe kufizojnë konkurrencën e lirë dhe efektive.

Qëllimi ynë është që t'i kontribuojmë mirëkuptimit të problemit të konkurrencës në treg në të gjitha strukturat e Autoriteteve ekzekutive, legjislativë e gjyqësore dhe të marrim pjesë në ndryshimet e tyre, si dhe ta informojmë administratën shtetërore, por edhe shtetasit e gjëra të qytetarëve, lidhur me fenomenet të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e konkurrencës.

Nga konkurrenca në fund të fundit përfitojnë të gjithë: konsumatorët, bizneset dhe ekonomia në tërësi. Ajo ofron një ofertë dhe cilësi më të mirë si dhe çmime më të ulëta të produkteve dhe shërbimeve, e inkurajon inovacionin dhe ndikon në rritjen ekonomike.

Andaj edhe rritja e ndërgjegjësimit për nevojën e promovimit të saj është detyrë e jona.

FUSHËVEPRIMI QË MBULON INSTITUCIONI

STRUKTURA ORGANIZATIVE E AUTORITETIT

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës përbëhet nga Komisioni që është organ kolegjal vendimmarrës dhe Sekretariati që e përbëjnë nëpunësit civil si staf profesional dhe mbështetës.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E SEKRETARIATIT

Sekretariati i Autoritetit është organ administrativ i ngarkuar me ligj për të kryer monitorimin dhe hetimin e rasteve për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në treg. Sekretariati pas monitorimit dhe hetimeve harton raportet të cilat paraqiten pranë Komisionit për vendimmarrje.

Sekretariati përbëhet nga dy Departamente:

I. Departamenti Juridik dhe Administratës

Zhvillon politikat kadrovike dhe planet e Autoritetit për menaxhimin e personelit, koordinon procesin e hartimit të legjislacionit primar dhe sekondar në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin, Sekretarin dhe Drejtorët e Departamenteve, siguron përputhshmërinë e ligjeve dhe akteve nënligjore të propozuara nga Autoriteti me legjislacionin e Bashkimit Evropian (*Acquis Communautaire*) si dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë.

Ky Departament në bashkëpunim me Komisionin, Sekretarin dhe Drejtorët e Departamenteve përgatit planifikimin e buxhetit sipas kategorive ekonomike, siguron përgatitjen dhe dorëzimin me kohë të KASH-it, SZHMB-së, planit të keshit, pasqyrave e raporteve financiare, barazimet me Thesarin, regjistrimin e të hyrave, si dhe siguron e mbikëqyr shërbimet teknike si mirëmbajtjen, servisimin dhe regjistrimin e rregullt të automjeteve, regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurisë së Autoritetit në përputhje me legjislacionin në fuqi, etj. Ky Departament ka 6 të punësuar dhe ka nevojë edhe për 1 zyrtarë të lartë ligjor.

II. Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut

Mision kryesor ka hetimin e shkeljeve të konkurrencës në treg, ruajtjen dhe rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, sipas përcaktimeve të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe akteve nënligjore që dalin nga ky ligj.

Ky Departament synon që nëpërmjet zbatimit të procedurave hetimore të parashikuara me ligj, të mbikëqyr tregun dhe të propozojë masat e duhura për rivendosjen e konkurrencës në rastet e pengimit, kufizimit apo shtrembërimit të saj në treg, mbikëqyrë hetimin e tregjeve ku shfaqen praktikant anti-konkurrese, si ato të abuzimit me pozitën dominuese në treg, marrëveshjet e ndaluara dhe nëpërmjet përqendrimeve që krijojnë apo forcojnë pozitën dominuese pas përqendrimit, ruan konfidencialitetin zyrtar dhe tregtar për informacionet e dokumentuara, të marra nga bizneset dhe nga institucionet publike, entet rregullatore, shoqatat profesionale e tregtare dhe palë të tjera të përfshira ose jo nën hetim, etj.

Ky Departament ka 4 divizione (Divizioni i Marrëveshjeve të ndaluara, Pozitës Dominuese, Përqendrimeve dhe Divizioni i Analizës, Metodologjisë dhe të Drejtave ekskluzive).

RASTET E TRAJTUARA PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

MARRËVESHJET E NDALUARA

Rasti 1.

KUJTESA – IPKO kundër MPBAP dhe Telekom i Kosovës

Lidhur me rastin e IPKO vs MPBAP, gjatë vitit 2021 janë zhvilluar takime me zyrtarët e MPBAP, Telekomit i Kosovës, Ministrisë së Mbrojtjes, lidhur me mundësinë e marrjes së detyrimeve sipas Ligjit për mbrojtjen e Konkurrencës. Gjatë vitit 2020 qeveria ka marrë vendim me të cilin iu ka lejuar të gjitha Institucioneve të Republikës së Kosovës, që të marrin shërbime nga Telekomit pa procedura tenderuese. Autoriteti i Konkurrencës ka lëshuar një rekomandim lidhur me këtë çështje.

Lidhur me rastin pas funksionimit të Komisionit të Autoritetit, lënda do të procedohet për vendimmarrje.

Rasti 2.

Rasti i murit “Vinkel”

Me dt. 29.10.2020 Autoriteti ka pranuar kërkesën nga operatori ekonomik Betonika Shpk me pretendimet se vendimi i Ministrisë së Tregtisë përkatësisht Divizioni për Mbrojtje Industriale ka çrregulluar konkurrencën tregtare duke i dhënë të drejtën ekskluzive vetëm një operatori ekonomik për prodhimin e një produkti të quajtur Muri Vinkel. Për shqyrtimin e kësaj ankese Autoriteti ka zhvilluar disa takime me përfaqësuesit e operatorëve ekonomik dhe Divizionin për Mbrojtje Industriale të Ministrisë së Idutrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe kornizën ligjore kemi përgatitur raportin e shqyrtimit paraprak dhe draft konkluzionin, nga është vlerësuar se nuk ka argumente për fillimin e procedurës. Autoriteti me konkluzion ka vendosur mbi bazën e vlerësimeve se nuk ka argumente për fillimin e procedurës hetimore në këtë çështje ndaj ndërmarrjes së Murit Vinkell Group dhe se shfuqizimi i vendimit të Agjencisë për Mbrojtje të Dizajnit Industrial nuk bie nën kompetencën e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Rasti 3.

Ankesa e “Posta Online” Shpk kundër “Express” Shpk

Autoriteti i Konkurrencës me dt. 12.03.2021 ka pranuar ankesë nga operatori ekonomik Posta Online Shpk, kompani kjo e cila kryen shërbime postare, e licencuar nga Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), kundër operatorit ekonomik Express Posta Shpk e cila gjithashtu kryen shërbime postare. Ankuesi pretendon se operatorit ekonomik Express Posta, është duke ofruar shërbime me çmime nën kosto, që sipas ligjit dhe rregullave të ARKEP, i cili deklaron se: *kompanitë postare nuk mund të konkurrojnë në treg nën çmimin dysHEME, marrë për bazë çmimoren e operatorit publik “Posta e Kosovës”, që dëmtton operatorin publik dhe të gjithë operatorët privat që operojnë në këtë treg.*

Ankuesi ka kërkuar nga Autoriteti të hetoj këtë çështje sepse: çmimi i ofruar prej 1 euro nuk mund t'i mbulojë shpenzimet e lëre më të krijojë të hyra, ndërsa operatori ka vendosur çmim nën kosto për të eliminuar konkurrencën.

Autoriteti, konsideron se vendimi i pavarur i një operatori ekonomik për të ulur çmimet në nivelin nën çmimin e kostos nuk dëmton domosdoshmërisht konkurrencën vetëm në rastet kur operatori ka pozitë dominuese në treg dhe ndërmerr këto veprime:

1. Ndalon ose ulë prodhimin, zvogëlon ofertën, ulë kualitetin e produktit, çmimet nuk janë në raport të arsyeshëm me vlerën ekonomike të produktit.
2. Reagon ndaj hyrjes ose konkurrencës nga një kompani më e vogël në treg duke ulur çmimin e saj dhe duke krijuar humbje, në përgjithësi ose në disa shitje specifike.
3. Çmimet nën çmimin e kostos ndodhin kur kompania me pozitë dominuese sakrifikon qëllimisht, humb financiarisht në kohë afatshkurtër me qëllim të eliminimit ose disiplinimit të konkurrentëve, ose me qëllim të parandalimit të hyrjes së tyre në treg. Kompania e bën këtë sakrificë kur konsideron se ka gjasa që t'i rikuperojë humbjet ose fitimet e humbura në një fazë të mëvonshme, pasi veprimet e saj të kenë krijuar efektin e mbylljes.
4. Konsumatorët mund të kenë përfituar nga çmimet më të ulëta në planin afatshkurtër, por në planin afatgjatë do ta kenë më keq për shkak të dobësimit të konkurrencës që do të sjellë çmime më të larta, cilësi më të ulët dhe më pak zgjedhje.

Promovimi i shitjeve, është një teknikë promovuese e marketingut të cilën e përdorin operatorët ekonomik për t'i bërë produktet dhe shërbimet e tyre më tërheqëse për konsumatorët, ato janë nxitje për konsumatorët për të blerë një produkt ose shërbim përmes një përfitimi për konsumatorët, promovimet e shitjeve janë të ndryshme p.sh: oferta falas, oferta dy produkte me çmimin e një produkti, oferta për para, shitje me gjysmë çmimi, etj.

Autoriteti, bazuar në pasqyrën e tregut të shërbimeve postare të publikuara nga (ARKEP), për vitin 2019, gjen se Express Posta sipas të hyrave kishte 2.09% të pjesëmarrjes në treg, që sipas kësaj nuk e përmbush kushtin ligjor për pozicion dominues sipas nenit 10 të Ligjit Nr. 03/L- 229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Në mungesë Komisionit, Autoriteti nuk ka mundur të nxjerr vendim për këtë rast.

Autoriteti, konstaton se Operatori ekonomik Express Posta gjatë periudhës 15-31 Mars të vitit 2021, në 11 vjetorin e hapjes së saj kishte lansuar ofertën me çmim në vlerë prej 1 euro vetëm në një produkt të caktuar në Letër Print (pliko). Këtë ofertë e kishte ofruar për një periudhë afatshkurtër me të cilët mund të përfitonin klientët, oferta për një periudhë të caktuar nga një kompani e cila nuk kishte pozitë dominuese dhe veprimet e tilla nuk kishin ndikim të ndjeshëm në treg, e me këtë sjellje nuk përbënin shkelje të Ligjit Nr. 03/L – 229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Rasti 4.

Kuvendi i Kosovës – Departamenti i Prokurimit

Autoriteti i Konkurrencës, me datë 5 Tetor 2021 nëpërmjet e-mail zyrtar ka pranuar një kërkesë nga Departamenti i Prokurimit i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kërkesa ka të bëjë lidhur me disa paqartësi të cilat ka hasur gjatë vlerësimit të një aktiviteti të prokurimit, *Shërbimet mbështetëse në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës me numër të prokurimit: 101-21-4686-2-1-1 (KU101 21 018 211)*.

Dyshimet janë mbi atë se kompanitë ofertuese kanë manipuluar me oferta.

Në vlerësim të parë duket se ka manipulim të ofertave të një personi, i cili ka plotësuar formularin e tenderit të ofertës 1 (konzorcium A dhe B) e po ashtu është person autorizues për nënshkrimin e kontratave të kompanisë A, po ashtu i njëjti person në dosjen e tenderit shihet se ka autorizim për nënshkrimin e kontratës edhe për kompaninë D. Lidhur me rastin sipas vlerësimit të parë duket se kemi manipulim në oferta të tenderëve publik. Rasti do të trajtohet pas funksionimit të Komisionit të AKK-së për të marrë konkluzion mbi fillimin e hetimeve ndaj kompanive ofertuese në këtë aktivitet të prokurimit.

POZITA DOMINUESE

Rasti 1.

Rasti i energjisë elektrike KEDS dhe KESCO

Për fillimin e procedurës hetimore ndaj ndërmarrjeve KEDS Sh.a. dhe KESCO Sh.a, për shkak të dyshimeve të bazuara për arritjen e Marrëveshjes së ndaluar apo praktikë e bashkërenduar dhe Abuzim me Pozitën Dominuese.

Përshkrimi i rastit:

Autoriteti i Konkurrencës me datë 04.12.2020 ka marrë Konkluzion për fillimin e procedurës hetimore ndaj KEDS Sh.a. dhe KESCO Sh.a.

Gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit në tregun e energjisë elektrike në Republikën e Kosovës, Autoriteti ka konsultuar dokumente të shumta rreth funksionimit dhe operimit të këtij tregu. Ka analizuar me kujdes bazën ligjore të funksionimit të sektorit të energjisë elektrike dhe në kuadër të kësaj ka grumbulluar dëshmi dhe dokumente të vlefshme, ka zhvilluar intervista dhe biseda me akterë të ndryshëm të shoqërisë, me qëllimin e vetëm, që t'i forcojë dyshimet e veta mbi shkeljet potenciale që palët në procedurë mund t'i kenë bërë në këtë treg.

Dyshimet e bazuara të Autoritetit janë se ndërmarrja KEDS Sh.a. dhe KESCO Sh.a. kanë abuzuar me pozitën e tyre dominuese në treg dhe kanë arritur marrëveshje të ndaluar apo praktikë e bashkërenduar në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës përkatësisht nenin 4 dhe 11.

Autoriteti gjatë shqyrtimit paraprak të situatës në tregun e energjisë elektrike ka vërejtur se pala në procedurë KEDS Sha ka abuzuar me pozitën dominuese:

- a) Duke krijuar pengesa për hyrje në treg ndaj Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE),
- b) Duke kërkuar nga BRE-të por edhe investorët e tjerë, që në rastet kur ata bëjnë investime në trafo-stacione, ato investime dhe prona ku gjendet trafo-stacioni të barten në pronësi të ndërmarrjes KEDS Sh.a.
- c) Duke vendosur kufizime në pajisje apo produkte që nevojiten për t'u kyçur në sistemin e shpërndarjes, duke kërkuar nga investitori që të gjitha pajisjet që nevojiten të instalohen, të jenë të një marke të pranueshme për KEDS Sh.a. si dhe të kenë teste të tipit të duhur sipas procedurave të brendshme të KEDS Sh.a.

Autoriteti gjatë shqyrtimit paraprak të situatës në tregun e energjisë elektrike gjithashtu ka vërejtur se palët në procedurë KEDS Sh.a. dhe KESCO Sh.a. kanë arritur Marrëveshje të ndaluar apo praktikë të bashkërenduar:

- a. Duke krijuar pengesa për hyrje në treg ndaj operatorëve të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) dhe investorëve tjerë, në atë mënyrë që:
 - i. Ka shfrytëzuar të njëjtin objekt,
 - ii. Ka shfrytëzuar ekspertët e njëjtë,
 - iii. Ka mbajtur kontabilitetin e përbashkët nga e njëjta zyre,
 - iv. Ka bërë shkëmbimin e informacioneve.

Se çfarë u tha më lartë, ndërmarrja KEDS Sh.a. në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthort kanë vendosur çmimin jo real të blerjes apo shitjes, ose kushte tjera të padrejta tregtare, kanë zbatuar kushte të ndryshme të transaksioneve për punët e njëjta me ndërmarrjet tjera duke i sjellë ato në një pozitë të pafavorshme në raport me konkurrencën dhe kanë vendosur çmime ose kushte tjera, që kanë si objekt ose si pasojë pengimin e hyrjes ose nxjerrjes jashtë tregut relevant të konkurrentëve të veçantë ose të një produkti të tyre.

Se çfarë u tha më lartë, ndërmarrjet KEDS Sh.a. dhe KESCO Sh.a. kanë arritur marrëveshje të ndaluar apo praktikë të bashkërenduar në atë mënyrë që: kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta me ndërmarrje të tjera tregtare, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurruese; kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.

Gjatë muajit shkurt 2021 Autoriteti ka pranuar komentet nga ndërmarrjet KEDS Sh.a. dhe KESCO Sh.a. Gjatë muajit mars 2021, lidhur me dyshimin për bartjet e pronave private ku gjinden trafo-stacionet elektro-energetike të cilat figurojnë në pronësi të KEDS-it në sistemin kadastral të komunave, Autoriteti, ka kërkuar informacion nga këto komuna:

1. Komunës së Prishtinës
2. Komunës së Mitrovicës

3. Komunës së Pejës
4. Komunës së Gjakovës
5. Komunës së Ferizajt
6. Komunës së Gjilanit
7. Komunës së Prizrenit

Pas marrjes së dokumentacioneve nga komunat dhe komentet e ndërmarrjeve të ofruara nga KEDS Sh.a. dhe KESCO Sh.a. si dhe pas funksionimit të Komisionit rasti do të shqyrtohet dhe analizohet deri në përfundim.

MENDIMET PROFESIONALE

Rasti 1.

Implikimi nga mbrojtja e markave tregtare në politikën e konkurrencës “IMPORTI PARALEL”

Përshkrimi rastit:

1. Konfliktet midis ligjit të konkurrencës dhe të drejtave të pronësisë intelektuale, ndodhin në zbatimin e rregullave kombëtare të mbrojtjes së markës tregtare, në importet paralele të produkteve të markës tregtare. Ndërmarrjet mbrojnë produktet e tyre me një markë tregtare, duke mbrojtur ose mbyllur territorin kombëtar nga importet.
2. Në pjesën më të madhe të vendeve të Ballkanit Perëndimor, po ashtu edhe në Kosovë, vlen Parimi i Ezaurimit Kombëtar i cili është adoptuar në Republikën e Kosovës, me nenin 12 të Ligjit nr. 04/L-026 për Marka Tregtare. Ky parim ka për pasojë ndalimin e importit paralel, përveq në rastet kur leja nga pronari i cili ka mbrojtur Markën Tregtare pranë organeve kompetente i është dhënë edhe kompanisë tjetër.
3. Në përgjithësi, patentat, markat tregtare, të drejtat e autorit (*që do të referohen si të drejta të PI-së*) janë të drejta ekskluzive të fituara për shpikjet në lidhje me produktet ose proceset. Një arsye kryesore për mbrojtjen ligjore të të drejtave të PI-së është inkurajimi i zhvillimit të ideve dhe teknologjisë së re që duhet të jenë pro-konkurrese dhe të dobishme për mirëqenien e konsumatorit. Motivimi për mbrojtjen e të drejtave të PI-së është që duke lejuar shpikësin e një produkti ose procesi të ri mbrojtje ligjore për një periudhë të caktuar kohe dhe duke parandaluar që të tjerët të kopjojnë atë, ai ka një mundësi për të përfituar nga shpikja. Kjo, në radhë të parë siguron një nxitje për të investuar.
4. Nisur nga fakti që kompani të ndryshme mund të prodhojnë produkte të natyrës së njëjtë apo konkurrese, markat tregtare u mundësojnë publikut të dallojnë prodhimet e kompanive përkatëse prej njëra tjetrës. Llojet e markave tregtare mund të jenë fjalët, logot, simbolet, dizajni i paketimit, ose çdo gjë tjetër e identifikueshme nga konsumatorët që shërben të tregojë një burim të caktuar, gjësend, apo shërbim. Qëllim kryesor i markës tregtare është t’u mundësojë publikut të dallojnë gjësendet apo shërbimet e një kompanie. Rëndësi tejet të madhe prej markave tregtare, gjithashtu, ka mbrojtja e pronarit prej fitimit të ndonjë subjekti apo konkurrenti imitues, ku në bazë të mbrojtjes me

ligj, pronarit nuk i kërcënohet fitimi nga shërbimi i ofruar apo gjësendi i shitur.

5. Importi paralel ka aspekte juridike dhe ekonomike: Ekonomikisht, ajo promovon disponueshmërinë e mallrave të markës tregtare me çmime të ndryshme, gjë që parandalon krijimin e një monopoli tregtar. Një qasje monopolistike, në një treg paralel pa import do të çonte në çmime të fryra të mallrave të shitura nga pronari i markës tregtare ose tregtari i autorizuar. Në mungesë të alternativave më të lira, konsumatorët do të ishin të detyruar të blinin mallra me çmimin e përcaktuar nga monopolisti. Kjo mund të ketë një efekt negativ në tregun e përgjithshëm, si dhe në ofertën dhe kërkesën. Ligjërisht, është thelbësore për të parandaluar mashtrimin dhe konfuzionin midis konsumatorëve në lidhje me burimin ose cilësinë e produkteve, dhe për të mbrojtur interesat ekonomike të pronarëve të markave tregtare.
6. Në rrafshin e politikave të konkurrencës, është i rëndësishëm identifikimi i elementeve pozitive dhe negative të importit paralel për të vlerësuar impaktin në një treg. Përkundër efekteve të mundshme negative, përgjithësisht është rënë dakord që tregtia paralele, kur lejohet, ka efekte pozitive dhe është përgjithësisht e mirëpritur. **E para** dhe më e rëndësishmja, tregtia paralele rrit konkurrencën në një treg të caktuar. Teoria themelore e ofertës dhe kërkesës tregon se furnizimi shtesë i mallrave çon në çmime më të ulta. Kjo është veçanërisht e vërtetë nëse konkurrenca ndërmjet markave (konkurrenca midis markave të njëjta apo Intra brand Competition) është e dobët dhe ndërkohë ekziston vetëm një kanal i shpërndarjes, shitës të veçantë janë në gjendje të ruajnë çmime më të larta për shkak të mungesës së konkurrencës. Sapo të lejohet tregtia paralele, konkurrenca brenda markës (*konkurrenca midis së njëjtës markë*) intensifikohet dhe shitësi detyrohet të konkurrojë me importuesit më agresivisht që nga ana tjetër shpie në uljen e çmimeve. Importet paralele gjithashtu parandalojnë që pronarët e të drejtave të PI-së të segmentojnë tregjet, duke përjashtuar mundësinë e diskriminimit me çmime (ose të paktën zvogëlimin e shtrirjes) midis tyre.
7. Sa i përket **efekteve negative** një nga argumentet kryesore kundër tregtisë paralele është “**udhëtimi falas**”. Mund të argumentohet se tregtia paralele lehtëson kalimin e lirë të investimeve të bëra nga pronari i të drejtave të PI-së, gjë që nga ana tjetër zvogëlon stimujt që në radhë të parë të investohet. Duket se është e padëshirueshme që një importues i paautorizuar të lejohet të privojë pronarin e të drejtave PI-së nga përfitimet pa kontribuar në investimin e tij.
Së dyti, ndikimi negativ në imazhin e markës shpesh përdoret si argument kundër tregtisë paralele. Argumentohet se tregtia paralele ndikon negativisht në perceptimin e një marke (*markë tregtare*) pasi ajo shitet nga distributorë të paautorizuar, gjë që rezulton në uljen e vlerës së kësaj marke tregtare.
Së treti, kufizimet në tregtinë paralele mund të lejojnë një caktim çmimi diskriminues, d.m.th. caktimi i një çmimi më të lartë në territoret ku gatishmëria e klientit për të paguar është më e lartë dhe caktimi i një çmimi më të ulët atje ku ajo gadishmëri është më e ulët.
Së katërti, importet paralele mund të çojnë në efekte afatgjata negative në mirëqenien e konsumatorit, sepse zvogëlimi i fitimeve mund të zvogëlojë stimujt e firmave për të investuar në inovacion duke ditur që do t’ju duhet të përballen me konkurrencën nga importues paralelë. Ky është një nga argumentet kryesore që ngrihen kundër tregtisë paralele në industrinë farmaceutike, pasi kërkim-zhvillimi është veçanërisht i kushtueshëm në atë sektor.
Së fundmi, mund të argumentohet se konsumatorët mashtrohen disi kur mendojnë se po blejnë mallra nga një kanal i autorizuar, ndërsa në të vërtetë nuk është kështu.
8. Të drejtat e PI-së u japin pronarëve të tyre të drejtë ekskluzive (**monopole**). Nga ana tjetër, ligji i konkurrencës përpiqet t’i mbajë tregjet e hapura për konkurrencë. Edhe pse mund të duket

kontradiktore në shikim të parë, si ligji për markat tregtare (Pronësisë Intelektuale) ashtu edhe ligji i konkurrencës, ndajnë të njëjtat qëllime themelore të mirëqenies së konsumatorit dhe promovimin e inovacionit. Inovacioni është thelbësor për një treg të hapur dhe konkurrues.

9. Efektet e importit paralel përmes markave tregtare të mbrojtura, vërehen në çmimet e produkteve të mallrave të konsumit (makineri, produkte farmaceutike, veshje, këpucë, materiale ndërtimi, makineri industriale, etj.).
10. Sa i përket këndvështrimit të Prokurimit publik, me theks të veçantë tek sektori farmaceutik, ekzistenca e importeve paralele është gjithashtu e rëndësishme sepse zgjidhja ekzistuese ligjore kufizon numrin e ofertuesve të mundshëm, si dhe konkurrencën e çmimeve. Importet paralele mundësojnë një numër më të madh të ofertuesve të mundshëm, të cilët blejnë produkte që i nënshtrohen prokurimit publik nga burime të ndryshme, ulin çmimin fillestar të produktit, i cili në të njëjtën kohë zvogëlon vlerën e prokurimit, duke arritur kështu në kursime të konsiderueshme të buxhetit.
11. Praktikën më të mira Evropiane si bazë e funksionimit të tregut të brendshëm, përveç nxitjes së konkurrencës së shëndetshme, theksojnë se importet paralele gjithashtu nxisin dhe zhvillojnë mirëqenien e konsumatorëve duke pasur parasysh që importet nga vendet që ofrojnë çmime më të ulëta të mallrave krijojnë një presion mbi tregtarët ekzistues në vendin e destinacionit për të ulur çmimet.
12. Kufizimet e importit paralel brenda BE-së vërehen nga këndvështrimi i shkëlqesës së konkurrencës sipas nenit 101 (1) të TFEU-së, të cilat si qëllim të tyre kanë një kufizim të rëndësishëm, shtrembërim ose parandalim të konkurrencës.
13. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë të konsiderojnë në të ardhmen çështjen e Humbjes së të drejtave të fituara nga marka tregtare “ezaurimit kombëtar” për markat tregtare të mbrojtura të cilat ndërlidhen me importin paralel.

Rasti 2.

IPKO LLC vs ARKEP (Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare) “NEUTRALITETI I KONKURRENCËS”

Përshkrimi i rastit:

- I. Autoriteti i Konkurrencës, angazhohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të Konkurrencës (*Abuzimit me Pozitë Dominuese, Marrëveshjeve të Ndaluara, Praktikave të Bashkërenduara dhe Realizimit të Përqendrimeve të pa autorizuar*), nga ndërmarrjet private apo publike, por edhe nga kufizimet e shkaktuara nga administrata shtetërore dhe entet rregullatorë në territorin e Republikës së Kosovës dhe jashtë saj, nëse këto veprime kanë efekte në Kosovë.
- II. Autoriteti, thekson se zbatimi i parimit të barazisë është detyrim, ndërsa vlerësonse moszbatimi i parimit të barazisë, përveq në rastet kur arsyetohet objektivisht, mund të dobësojë pozitën e operatorëve në treg, pra që situatat e krahasueshme të mos trajtohen ndryshe dhe që situata të ndryshme të mos trajtohen në të njëjtën mënyrë, përveç nëse një trajtim i tillë justifikohet objektivisht.
- III. Nga këndvështrimi i politikave të konkurrencës, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike

dhe Postare të vazhdojë të kujdeset, që gjatë procesit të Planit të Migrimit të Kodeve ekzistuese +377, +381 dhe +386 në Kodin Telefonik Shtetëror +383 të Republikës së Kosovës, të mbizotëroj efekti i “Neutralitetit të Konkurrencës” (Parimi i përgjithshëm i trajtimit të barabartë dhe mos diskriminimit) përmes së cilit sigurohet që subjektet të cilat operojnë në një treg nuk i nënshtrohen avantazheve ose disavantazheve në pikëpamje të konkurrencës.

- IV. Institucionet duhet të jenë në mbrojtje të interesit publik, gjithashtu duhet të kujdesen që të krijojnë ambient të përshtatshëm për operatorët aktual dhe nxitës për hyrjen e operatorëve të rinj në treg. Zbatimi i politikave të neutralitetit konkurrues është e një rëndësie të veçantë në sektorët e rregulluar dhe të liberalizuar. Aplikimi i tyre nga ana e Autoriteteve Publike nënkupton, që përfitimet e konkurrencës do të rriten, andaj adresimi i neutralitetit është një instrument i rëndësishëm i politikës së konkurrencës, që duhet të adresohet për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.
- V. Autoriteti, lëshon këtë Mendim Profesional, nga pikëpamjet e Ligjit dhe Politikave të Konkurrencës

DIVIZIONI I ANALIZËS, METODOLOGJISË DHE TË DREJTAVE EKSKLUZIVE

Rasti 1.

Kërkesë nga Sektori farmaceutik i dt.12.05.2020, mbi Njoftimi për AKK në lidhje me moszbatimin të “Mendimit Profesional” me Nr. 20/19

Përshkrimi rastit:

Disa kompani farmaceutike (3) kanë kundërshtuar Ministrinë e Shëndetësisë se nuk është duke e zbatuar drejtë Mendimin Profesional të AKK-së mbi bazën e këtyre pretendimeve:

Pas, fillimit të periudhës së implementimit të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/19 rreth unifikimit të çmimit të produkteve medicinale, Autoriteti i Konkurrencës do të trajtojë problemet nëse ato do të shfaqen në lidhje me konkurrencën në sektorin farmaceutik. Gjatë vlerësimit do të identifikohen nëse ekzistojnë arsyeime për çdo kufizim të konkurrencës dhe do të vlerësojmë nëse alternativat më pak kufizuese do të arrijnë qëllimin e synuar të politikës shëndetësore. Ne gjithashtu do të bëjmë rekomandime dhe sugjerime për qasje alternative për të arritur qëllimet e politikës shëndetësore duke reduktuar kufizimet në konkurrencë, në bashkëpunim me palët e interesit. Përderisa Ligji për Produkte medicinale nuk ka bërë përjashtime, përkatësisht e ka pamundësuar që këto produkte të veçohen përkatësisht të mos e bëjnë rregullimin e këtyre. Në situatën aktuale është paraparë rregullimi i çmimeve të produkteve medicinale, përkatësisht i të gjitha produkteve që posedojnë Autorizimin për Marketing duke përjashtuar këtu vetëm ato produkte të cilat nuk i nënshtrohen regjistrimit në Agjencinë për Produkte dhe Pajisje Medicinale si shtesat ushqimore, produktet herbale, disa vitamina të cilat nuk regjistrohen, etj.

Autoriteti konsideron se me amandamentimin e Ligjit për produkte dhe Pajisje Medicinale kjo pikë të merret parasysh dhe të vlerësohet nga autoritetet për tu sqaruar dhe rregulluar me Ligj.

Autoriteti i Konkurrencës ka paraparë që: “Ministria e Shëndetësisë duhet të aplikoj mekanizmat “Claw-Back”, atëherë kur çmimet e medikamenteve të rimbursueshme ulën.”. Në këtë rast konsiderojmë se me hartimin e rregulloreve nga Fondi për sigurim Shëndetësor kjo pikë duhet të merret parasysh për barnat që do të jenë në listën për rimbursim.

Udhëzimi ka përcaktuar metodologjinë dhe mënyrën se si bëhet përcaktimi i çmimit dhe kjo vlenë për të gjitha produktet medicinale të cilat posedojnë regjistrimin. Kjo do të thotë se në momentin kur një produkt regjistrohet edhe i nënshtrohet mekanizmave të rregullimit të çmimit dhe pastaj ai mund të jetë pjesë e tregut të lirë, apo të bëhen furnizime në institucione publike apo private. Këtu nuk ka ndonjë pikë kundërshtuese dhe as përjashtuese përkundrazi konsiderohet se kjo është edhe një nga parakushtet të cilat është dashur të plotësohen në mënyrë që të fillojë procesi i reimbursimit. Në mungesë të një rregullimi të tillë fondi për sigurim shëndetësor nuk mund të bëjë reimbursimin financiar rrjedhimisht nuk do të ishte funksional.

Kjo më shumë është çështje e sektorit farmaceutik, megjithatë Autoriteti konsideron se kompanitë me renome, pjesëmarrjen e tyre e kushtëzojnë kryesisht në bazë të tregjeve të rregulluara dhe përkundrazi nuk gjenden në tregje të cilat nuk kanë mekanizma rregullues.

Normat e udhëzimit administrativ nuk flasin për rabate dhe aksione. Ato kanë përcaktuar çmimet shitëse me shumicë dhe pakicë dhe pjesa e rabateve apo aksioneve rregullohet edhe me norma të tjera financiare të cilat bëhen në mes të prodhuesve, distributorëve apo barnatoreve.

Kjo pjesë e deklarimit të çmimit nga ana e shitësve me shumicë nuk është relevante pasi që Udhëzimi Administrativ Nr. 02/19 ka përcaktuar se deklarimin e bën mbajtësi i autorizimit të marketingut apo me autorizim distributori apo përfaqësuesi ligjor i tyre. Kurse komisioni në këtë rast ka zbatuar metodologjinë e udhëzimit dhe ka bërë krahasimet e kërkuara apo përcaktuara.

Pas, fillimit të periudhës së implementimit të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/19 rreth unifikimit të çmimit të produkteve medicinale, pasi që ende Autoriteti përkatësisht Ministria e Shëndetësisë nuk e ka përfunduar këtë proces duke qenë në fazën e shqyrtimit të ankesave, Autoriteti i Konkurrencës do të trajtojë problemet nëse ato do të shfaqen në lidhje me konkurrencën në sektorin farmaceutik. Gjatë vlerësimit do të identifikohen nëse ekzistojnë arsyeime për çdo kufizim të konkurrencës dhe do të vlerësojmë nëse alternativat më pak kufizuese do të arrijnë qëllimin e synuar të politikës shëndetësore. Në gjithashtu do të bëjmë rekomandime dhe sugjerime për qasje alternative për të arritur qëllimet e politikës shëndetësore duke reduktuar kufizimet në konkurrencë, në bashkëpunim me palët e interesit.

Rasti 2.

Analiza e sektorit bankar

Përshkrimi rastit:

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2021 në bashkëpunim me projektin e BE-së, ka filluar studimin e tregut në sektorin e shërbimeve bankare dhe financiare, duke u bazuar në nenin 28 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Qëllimi kryesor i këtij studimi të tregut është të vlerësojë strukturën e tregut dhe shkallën e konkurrencës në këtë sektor.

Kemi përgatitur pyetësorët për pjesëmarrësit kryesor në treg (9 banka komerciale), kemi pranuar përgjigjet nga bankat dhe jemi duke i përpunuar këto të dhëna.

PËRQENDRIMET E NDËRMARRJEVE NË TREG

Nr.	Emri i biznesit (KOMPANIA)	Nr. protokollit dhe data e kërkesës	Veprimtaria ekonomike	Taksa 100€ / Data e pagesës	Data e miratimit/ Vendimi	Taksa 3.000€/ Data e pagesës
1.	NOMAD FOODS EUROPE LIMITED	135/21-01/H 02.04.2021	Këshillime, biznese, dhe menaxhim, (përfaqësimi i ndërmarrjeve të huaja, shërbime të kontabilitetit, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e pasurive të patundshme, shitja dhe blerja e mallrave, shërbime tregtare, hulumtimi i tregut dhe sondazhi i opinionit publik).	02.04.2021	20.05.2021	26.05.2021
2.	IPKO TELECOMM UNICATION S LL.C	145/21-01/H 15.04.2021	Telekomunikimi kabllor, tregtia me pakicë e mallrave të reja në dyqane të specializuara.	16.04.2021	08.06.2021	17.06.2021
3.	GRAND AUTOMOTI VE LL.P	173/21-01/H 28.05.2021	Tregtia më shumicë dhe pakicë, importi dhe eksporti i mallrave ushqimore, industriale, ëmbëltore, pajise fizike, sanitari, dru, pajise elektronike mjete automatike, veshje, ilaçe, materiale ndërtimore, produkte bujqësore, bagëti, lëndë të para për industri, pjesë këmbimi, makineri, dhe pajisje këmbimi, artikuj shkrimi, pajise për zyre, pajise shtëpiake dhe transport.	28.05.2021	Në procedurë, mungesa e komisionit	-----
4.	BIMAIL d.d BRCKO DISTRIKT B.H	187/21-01/H 02.06.2021	Tregtia me shumicë e drithërave për kafshë, duhan të pa përpunuar, fara dhe ushqime për kafshë.	03.06.2021	Në procedurë, mungesa e komisionit	-----
5.	EP CORPORATE GROUP A.S (EPCG)	224/21-01/H 15.07.2021	Shitja më pakicë e ushqimeve dhe produkteve të përafërta.	15.07.2021	Në procedurë, mungesa e komisionit	-----
6.	Q.D VILA BOGATINA SH.P.K ALFI	227/21-01/H 23.07.2021	Ofron shërbime në fushën diabetologjis, diagnostik mjekësorë në fushën	23.07.2021	Në procedurë, mungesa e	-----

	PE		diagnostifikimit radiologjik të imazhit MR, rreze X dhe diagnostifikimi me ultratinguj, terapi dhe teknologji.		komisionit	
7.	Q.D VILA BOGATINA SH.P.K NEURODINA	226/21-01/H 23.07.2021	Spektori shëndetësor për neurologji dhe diagnostikë EMG.	23.07.2021	Në procedurë, mungesa e komisionit	-----
8.	ALLIED BEVERAGES ADRIATIC D.O.O- BEOGRAD- ZEMUN	246/21-01/H 20.08.2021	Prodhi i pllakëzave të plastikes, fletëzave, tubave dhe profileve.	23.08.2021	Në procedurë, mungesa e komisionit	-----
9.	RAIFFEISEN BANK A.D BEOGRAD	248/21-01/H 03.09.2021	Aktivitet tregtar në sektorin financiar dhe bankar, ndërmjet filialeve qe posedon.	07.09.2021	Në procedurë, mungesa e komisionit	-----
10.	IPKO TELECOMM UNICATION S LL.C	259/21-01/H 27.09.2021	Telekomunikimi kabllor, publikimi i softuerëve të tjera, transmetimin e programeve televizive, teknologji tjera informative dhe aktivitete shërbyese kompjuterike, përpunimi i të dhënave, postimi i informacioneve dhe aktivitete e lidhura me to.	29.09.201	Në procedurë, mungesa e komisionit	-----

TREGJET E MONITORUARA

Rasti 1.

Analiza e tregut në sektorin e çimentos

Përshkrimi rastit:

Autoriteti i Konkurrencës ka analizuar tregun e çimentos në Kosovë, duke nxjerrë strukturën e tregut, pjesëmarrësit në tregun përkatës, sjelljen e tyre, përparësitë ose dobësitë dhe nivelin e konkurrencës në këtë treg. Kemi analizuar prodhimin vendor të çimentos, importin e kompanive kryesore që afarojnë në këtë treg, pjesëmarrjen e tyre në tregun e Kosovës, për periudhën 3 vjeçare (2018, 2019 dhe 2020) gjithashtu kemi bërë krahasimin e çmimeve me tregjet rajonale (Shqipëri, Maqedoni e Veriut në raport me prodhimin vendor).

Gjithashtu është analizuar pjesëmarrja e Titan Group në Kosovë, eksportuesit nga fabrikat e tjera: Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Greqia, krahasimi i çmimeve me vendet e rajonit, sjelljen e tyre një pamje të situatës, fenomeneve dhe dobësitë e mundshme të tregut që në raste të caktuara mund të shkaktojnë shkelje të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Analiza është e përfunduar dhe pas funksionimit të Komisionit do të publikohet në ueb faqen e AKK-së.

Rasti 2.

Analiza e tregut për produktet grurë, miell, gaz, naftë, benzinë, sheqer, vaj dhe transport.

Përshkrimi rastit:

Autoriteti, në muajin Nentor të vitit 2021, ka filluar analizën e tregut të importeve për këto produkte:

1. Importet e Grurit ushqimor,
2. Importet e Miellit të grurit,
3. Importet e Gazit (Propan & Butan),
4. Transporti në importin e mallrave,
5. Importet e Sheqerit, dhe
6. Importet e Vajit.

Lidhur me këtë analizë, Autoriteti ka siguruar të dhëna për tregjet përkatëse nga Dogana e Kosovës dhe institucione tjera. Gjithashtu Autoriteti ka përgatitur pyetësor/mbledhjen e të dhënave për kompanitë me pjesëmarrje më të madhe në treg, importuese dhe prodhuese. Autoriteti ka pranuar këto të dhëna dhe është në fazën e përpunimit të të dhënave lidhur me këtë analizë të tregjeve.

Rasti 3.

Monitorimi në tregun e shitjeve me pakicë

Përshkrimi rastit:

Autoriteti ka filluar monitorimin në tregun e shitjeve me pakicë, në tregun e Republikës së Kosovës. Fillimisht kemi hulumtuar praktikën në vendet e rajonit dhe ato të Bashkimit Evropian si praktika të cilat mund të na shërbejnë për një analizë (fillim të procedurës hetimore) tregu në sektorin e shitjeve me pakicë (Retail Sector).

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të fillohet me një analizë gjithëpërfshirëse ekonomike të dinamikës së konkurrencës në tregun në fjalë. Kjo përfshin identifikimin e dobësive të mundshme të tregut dhe në përputhje me gjetjet përkatëse, ofrimin e rekomandimeve adekuate të drejtuara në avancimin e sjelljes së ligjshme dhe të drejtë të biznesit të të gjitha ndërmarrjeve.

Po ashtu në mënyrë indirekte, qëllimi i kësaj analize është të promovojë konkurrencën në treg si rezultat i këtij monitorimi.

Rasti 4.

Sektori i Shëndetësisë – Laboratorët e licensuar për testim SARS-COV19

Përshkrimi rastit:

Gjatë vitit 2021, Autoriteti ka vazhduar monitorimin e Laboratorëve të Licensuar për testim SARS-COV19.

Autoriteti ka mbledhur informata javore nga laboratorët privat për çmimet e testeve. Monitorimi i laboratorëve ka filluar nga shtatori 2020 deri në muajin prill 2021.

Gjatë monitorimit Autoriteti ka konstatuar se tek testet PCR dhe testet serologjike nuk ka elemente të dyshimit për sjellje anti konkurruese sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Rasti 5.

Monitorimi i sektorit të Radio – Taksive

Përshkrimi rastit:

Duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, neni 28 paragrafi 2, neni 30, neni 38 paragrafi 1 dhe neni 61 paragrafi 3, me datë 15.10.2020, Komisioni i AKK-së ka autorizuar sekretariatën – Departamentin për mbikëqyrjen e Tregut, të siguroj informata për tregun e shërbimeve të taksive, qëllimi i të cilave është analiza e kushteve të konkurrencës për këtë shërbim, kompanive të cilat operojnë në tregun e shërbimeve të taksive në Republikën e Kosovës.

Gjatë vitit 2021 Autoriteti ka siguruar të dhënat nga Institucionet përkatëse dhe me këtë Autoriteti është duke përgatitur pyetësorët për mbledhjen e të dhënave për pjesëmarrësit në treg.

Rasti 6.

Monitorimi i produktit të vajit të Lulediellit

Përshkrimi rastit:

Autoriteti pas shqetësimeve të ngritura nga opinioni publik ka kryer monitorimin në tregun e Kosovës, lidhur me ngritjen e çmimit të vajit ushqimor, më konkretisht të vajit të lulediellit.

Nga monitorimi i tregut kemi konfirmuar se ka pasur një rritje të theksuar të çmimit të këtij produkti nga muaji janar i këtij viti. Për këtë arsye, Autoriteti menjëherë ka nisur procedurat për të parë nëse operatorët e tregut kanë bërë ndonjë shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, gjatë caktimit të çmimit. Bazuar në këtë ligj, bashkërendimi i operatorëve të tregut për ta caktuar çmimin e ndonjë produkti mund të jetë veprim që bie ndesh me ligjet në fuqi që e mbrojnë konkurrencën e ndershme në vendin tonë.

Sidoqoftë, nga monitorimi që kemi kryer në terren si dhe nga mbledhja e të dhënave nga institucionet shtetërore, kemi ardhur në përfundim që nuk ka elemente të ndonjë marrëveshjeje të ndaluar apo praktikë të bashkërenduar ndërmjet importuesve të vajit në Kosovë. Në fakt, bazuar në monitorimet të kryera, kemi konstatuar se rritja e çmimit të vajit ushqimor është rritje globale, e cila pastaj reflekton në mënyrë zinxhirore edhe në shtetin tonë, si importues i këtij produkti.

Çmimet e vajit të lulediellit në tregun botëror do të ndryshojnë ekskluzivisht në varësi të furnizimit dhe kërkesës. Në vitin 2020, shumë prodhues të mëdhenj botërorë, si Ukraina, Rusia, Bullgaria, Rumania, Moldavia, kishin një rendiment më të dobët të lulediellit, gjë që ndikoi në mënyrë të pashmangshme në këtë trend të çmimeve në bursat botërore. Duhet thënë poashtu se një rol në ngritjen e çmimit ka pasur edhe ndryshimi në politikat e disa vendeve që janë eksportues të mëdhenj, si fiksimi i politikave të importit dhe vendosja e taksave mbi vajin ushqimor.

Si përfundim është mbetur që ky treg të monitorohet edhe më tutje.

Rasti 7.

Monitorimi i berberëve në Komunën e Kaçanikut, Rahovecit, Mitrovicës dhe Pejës

Përshkrimi rasteve:

Zyrtarët e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe përfaqësuesit e shoqatave të berberëve janë takuar gjatë vitit 2021, për të diskutuar lidhur me paralajmërimet për një ngritje të bashkërenduar të çmimit të shërbimeve që ofrohen në këtë sektor.

Qëllimi i këtyre takimeve ka qenë që të njoftohen përfaqësuesit e këtij sektori se ngritja e bashkërenduar e çmimeve ndërmjet operatorëve përbën shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, me që krijon një situatë në të cilën konsumatorëve u pamundësohet të kenë mundësi të zgjedhjes së çmimit më të favorshëm për ta.

Në këtë kontekst, përfaqësuesit e floktarëve të këtyre komunave janë zotuar para zyrtarëve të AKK-së se nuk do ta zbatojnë një marrëveshje të tillë mes operatorëve për ngritje unanime të çmimeve.

Me këtë rast, Autoriteti i Konkurrencës u ka bërë thirrje të gjithë sektorëve që të përmbahen nga arritja e marrëveshjeve për ngritje të bashkërenduar të çmimeve, me që një gjë e tillë cenon konkurrencën në treg dhe sanksionohet me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Rasti 8.

Monitorimi i tregut në sektorin e gastronomisë në Komunën e Prishtinës, Mitrovicës dhe Gjilanit

Përshkrimi rastit:

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2021, pas shqetësimeve të publikut se në Komunitat e lartcekura, pronarët e kafeneve kanë bërë marrëveshje të ndaluar duke ngritur çmimin e disa produkteve, ka monitoruar këtë sektor.

Qëllimi i këtyre monitorimeve nga Autoriteti i Konkurrencës ka qenë avokimi dhe informimi i operatorëve se koordinimi për fiksimin e çmimeve është i ndaluar dhe është në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Operatorët janë zotuar se çmimet do të përcaktohen duke u bazuar në kërkesën dhe ofertën në treg.

Përkrahja nga projekti i financuar nga BE

Mbështetja e projektit të financuar nga Komisioni Evropian për Autoritetin Kosovë të Konkurrencës është një komponent i rëndësishëm në avancimin profesional të institucionit. Projekti ka luajtur një rol të veçantë në këtë drejtim, duke i ofruar stafit të AKK-së trajnime themelore dhe të avancuara në fushën dhe politikën e konkurrencës. Projekti njëherazi ka ofruar mendime dhe opinione, menaxhmentit rreth hartimit të metodologjive studiuëse të tregjeve, metodave investigative dhe grumbullimin e fakteve.

Autoriteti Kosovë i Konkurrencës është përfitues i projektit IPA2017, Projekti i financuar nga BE-ja “Mbështetje e BE-së për Autoritetin Kosovë të Konkurrencës dhe Komisionin e Ndihmës Shtetërore”, me vlerë të kontratës prej 2,998,000 €, që ka filluar punën në Prishtinë më 15 janar 2019. Projekti zbatohet nga një konsorcium i udhëhequr nga B&S Europe dhe duke përfshirë Këshillin e Konkurrencës së Republikës së Lituanisë, Kosovo Legal Services Company LLC dhe firma italiane Archidata. Projekti do të zgjasë deri më 15 maj 2022. Në mënyrë të përmblodhur, ne vijim janë aktivitetet kryesore të zhvilluara gjatë vitit 2021.

- Përfundimi i Programit Ndërmjetës të Trajnimit për AKK-në, hartimi dhe publikimi i manualeve;
- Përfundimi i Fazës I të ushtrimit të arkitekturës së Ndërmarrjes;
- Mbështetja e mëtejshme në Draft Ligjin të ri për Mbrojtjen e Konkurrencës;
- Ndryshimet dhe plotësimet e propozuara në legjislacionin aktual detyësor të konkurrencës në kontekst të Ligjit të ri për Mbrojtjen e Konkurrencës;
- Hartimi i Fjalorit gjithëpërfshirës të plotë të ligjit dhe politikave të konkurrencës;
- Tryeza me rregullatorë të tregjeve dhe Institucione vendore (BQK, Gjyqësorin, OSHP);

- Trajnim i përbashkët në lidhje me konkurrencën për AKK-në dhe rregullatorët e telekomit (ARKEP dhe energjisë (ZRRë);
- Vazhdimi dhe përfundimi i Studimit të Tregut për Konkurrencën në tregjet e Shërbimeve Bankare dhe Financiare në Kosovë;
- Trajtime për gjyqësorin për ligjin e konkurrencës;
- Një Konferencë për Ligjin dhe Politikën e Konkurrencës në Kosovë dhe një seminar i mundshëm për shoqatat e biznesit.
- Angazhimi i dy zyrtarëve të rinj për periudhën 9 mujore në AKK si praktikantë deri në mars 2022;

Disa nga projektet janë ende në fazën e implementimit dhe presim që edhe për të ardhmen do të vazhdoj përkrahja për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës.

AKTIVITETE TJERA

ANKESAT DHE KËRKESAT E OPERATORËVE EKONOMIK

Ankesë nga operatori ekonomik “Herc” BB ndaj Komunës së Shtërpçës

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, gjatë vitit 2021 ka pranuar ankesë/kërkesë, kundër operatorit ekonomik “Herc BB” Shtërpçë.

Ankesa është dorëzuar nga ndërmarrja PP “Progres”, me të cilën pretendon se Inspektorati ndërtimor i Komunës së Shtërpçës me datën 31.12.2020, ka ndërprerë montimin, kycjen e shërbimeve televizive kabllore për klientët në banesat e reja nga ndërmarrja PP “Progres” Shtërpçë.

Përfaqësuesit e Autoritetit të Konkurrencës kanë zhvilluar takim me Drejtorin e Inspektoratit Komunal të Shtërpçës, personat kompetent në këtë takim kanë deklaruar se ndërmarrja PP “Progres” “nuk ka pasur leje pune për të instaluar rrjetin në pronën komunale, për shkak se banesat dhe toka është pronë e së njëjtës”.

Autoriteti, konsideron se Komuna e Shtërpçës, bazuar në Rregulloren Nr. 05/2017 për Ndërtimin, Instalimin dhe Mbikëqyrjen e Infrastrukturës së Komunikimeve Elektronike e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, duhet trajtuar në mënyrë të barabartë ndërmarrjet në treg, trajtimi ndryshe duhet të bazohet në kritere objektive. Evitimi i favorizimit dhe krijimi i lehtësirave për ndërmarrjet e caktuara mundëson, krijimin e ndërmarrjeve që zotërojnë fuqi tregu dhe pengon ndërmarrjet e tjera të jenë konkurrese në treg, e posaçërisht ato ndërmarrje që janë në të njëjtin nivel të operimit dhe ofrimit të shërbimeve.

Nëse, Ndërmarrja PP “Progres” pas aplikimit për leje pune dhe plotësimit të kushteve ligjore, bazuar në Rregulloren Nr. 05/2017 për Ndërtimin, Instalimin dhe Mbikëqyrjen e Infrastrukturës së Komunikimeve Elektronike, komuna e Shtërpçës nuk e pajisë me leje pune, atëherë Autoriteti, do të ndërmarr veprime ligjore.

Përderisa, ankuesi nuk ka përfunduar çështjet paraprake, që nënkuptohet aplikimi dhe pajisja me leje pune, pranë organit kompetent respektivisht Komunës së Shtërpçës, Autoriteti gjatë shqyrtimit paraprak dhe situatës në tregun relevant, bazuar në nenin 75 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konsideron se rasti si i tillë nuk bie nën kompetencën e tij.

Rasti është përfunduar, palët janë njoftuar me shkresë me përfundimin e çështjes.

Kërkesë për vlerësim të marrëveshjes për të drejtën ekskluzive

Autoriteti i Konkurrencës përmes emailit ka pranuar një kërkesë lidhur me një kontratë të qiradhënies në një Qendër Tregtare të hapur në Ferizaj, e në të cilën kontratë palët kanë përcaktuar ekskluzivitetin. Qiradhënësi obligohet që për periudhën sa Kontrata dhe Anekset e saj janë në fuqi të mos jap me qira asnjë parcelë apo objekt, kujt do që mund të konsiderohet konkurrent nga ana e Qiramarrësit në Industrinë e njëjtë (market, Hipermarket, etj).

Si përfundim, pas një analize dhe vlerësimit të pyetjes së palës, se: Qiradhënësi obligohet që për periudhën sa Kontrata dhe Anekset e saj janë në fuqi të mos jap me qira asnjë parcelë apo objekt, kujt do që mund të konsiderohet konkurrent nga ana e Qiramarrësit në Industrinë e njëjtë (market, Hipermarket, etj).

Dhe se: a është në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës?

Autoriteti është në vlerësim të kësaj kërkesë.

Kërkesë nga Beta Group Shpk për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës

Gjatë vitit 2021, kompania Beta Group Shpk, ka paraqitur ankesë lidhur me procesin e zhdoganimit të fijeve të armaturës – trashësia si dhe vendi origjinës së produktit. Autoriteti ka vlerësuar se ankesa nuk bie nën domenin e trajtimit nga Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës. Është njoftuar pala me shkresë si dhe Dogana e Kosovës me dt. 02.08.2021

Oda e Afarizmit të Kosovës – OAK

Ankesa ndaj ndërmarrjes SharrCem për shkak se e njëjta ka njoftuar bizneset për një kohë shumë të shkurtër për ngritjen e çmimeve të çimentos. Sharr Cem ka njoftuar bizneset me të cilat bashkëpunon se ka marrë vendim për ndryshimin e çmimeve të çimentos, e me këtë vendim bizneset janë njoftuar nga mesi i muajit dhjetor, ndërsa që i njëjti do të hyjë në fuqi me datën 01 janar 2022.

Sipas ankesës së OAK me këtë njoftim që ka bërë Sharr Cem në afat shumë të shkurtër, edhe në të kaluarën i kanë dëmtuar rënd bizneset, duke marrë parasysh se bizneset bëjnë kontrata të mëhershme të çmimeve dhe detyrohen të i'u përmbahen atyre çmimeve që ka kontraktuar disa muaj më herët.

Autoriteti për të njëjtën çështje ka vendosur në vitin 2020 nga i njëjti ankues, andaj me rastin e funksionimit të Komisionit ankuesi do të njoftohet me përmbajtjen e përgjigjes lidhur me kërkesën.

BASHKEPUNIMI RAJONAL DHE NDËRKOMBËTAR

Bashkëpunimi me institucione tjera për zhvillimet në politikën e konkurrencës

Gjatë vitit 2021, Autoriteti në mënyrë të vazhdueshme ka raportuar dhe bashkëpunuar me Institucione tjera rreth zhvillimeve në fushën e politikës së konkurrencës. Këtu përfshihen raportimet në platformat online, raportet për nën-komitetin e MSA-së për Tregun e brendshëm, konkurrencën, mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetin publik.

Kemi plotësuar pyetësorët e hartuar nga Komisioni Evropian për fushën e konkurrencës, përgatitjen e kontributeve/inputs të institucioneve të Republikës së Kosovës për Raportin e KE-së për Kosovën, etj.

“Iniciativa ballkanike” nga Autoriteti Turk i Konkurrencës

Gjatë muajit gusht i jemi përgjigjur Autoritetit Turk të Konkurrencës, për nismën e re për krijimin e një "Iniciative Ballkanike" që synon të përmirësojë funksionimin efektiv të autoriteteve të konkurrencës dhe të bashkëpunojë në çështjet e përbashkëta të konkurrencës në rajonin e Ballkanit. Në përputhje me synimet tuaja të orientuara drejt së ardhmes në lidhje me bashkëpunimin rajonal në fushën e konkurrencës, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës mbështet plotësisht krijimin e një rrjeti të vendeve të Ballkanit dhe agjencive të tyre të konkurrencës që do të kishin efekte pozitive shumë-dimensionale në zbatimin e rregullave të konkurrencës.

Programi rajonal i Evropës Juglindore-SEE Competitiveness Outlook 2021 për Kosovën

Gjatë muajit Shtator 2021 është mbajtur takim virtual rreth publikimit të SEE Competitiveness Outlook 2021 për Kosovën. Programi rajonal i EKL -së ka pasur ndikim të konsiderueshëm duke ndihmuar ekonomitë e EKL-së në identifikimin e prioritetëve të reformës, nxitjen e zbatimit dhe afrimin e tyre me standardet e OECD-së dhe BE-së. Programi gjithashtu ka lehtësuar zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe me përfitime reciproke me ekonomitë e rajonit. Programi rajonal i Evropës Juglindore u krijua nën kujdesin e Paktit të Stabilitetit për një rajon të dobësuar nga konflikti, por i pajisur me burime dhe dinamizëm të pasur. Mandati, i nënshkruar në vitin 2000 nga nëntë qeveri të EKL-së, njohu zhvillimin e sektorit privat dhe bashkëpunimin ndërkombëtar si gurë themeli për rigjallërimin e rajonit. Që atëherë, qeveritë, drejtuesit e biznesit dhe shoqëria civile kanë punuar së bashku në bashkëpunim me OECD për të përmbushur sfidat ekonomike, duke përfshirë përballimin e krizës globale ekonomike dhe financiare dhe përgatitjen për pranimin në BE. Programi ka qenë gjithashtu i rëndësishëm në ndërtimin e kapaciteteve institucionale në rajon, duke lehtësuar dialogun teknik dhe të nivelit të lartë dhe transferimin e njohurive të OECD në fusha të ndryshme të politikave.

Rrjedha aktuale e konkurrencës, përfshin bashkëpunimin me 12 organe dhe drejtori të OECD-së dhe mbështetet në instrumentet e OECD-së të aplikuara në shtetet anëtare. Analiza dhe diagnoza e politikave të programit rajonal të EKL shfrytëzohet gjithashtu nga partnerët e tij dhe futet në dokumente strategjike siç janë: Raportet vjetore të Progresit të Komisionit Evropian ose priorizimi i burimeve të agjencive ndërkombëtare të zhvillimit.

Në të vërtetë, programi rajonal i SEE ka mbështetur rajonin për të hartuar dhe zbatuar reforma për të nxitur zhvillimin dhe konkurrencën e sektorit privat, për të tërhequr më shumë dhe më mirë investime dhe për të rritur standardet e jetesës. Gjatë vitit 2020 nga OECD na janë kërkuar plotësimi i Pyetësorit me të dhëna Kualitative dhe Kuantitative për Autoritetin (Rreth rasteve, punës së Autoritetit, Avokimit, Trajtimit të rasteve, etj.) Përmes këtyre pyetjeve janë nxjerrë nga OECD mbi gjetjet dhe rekomandimet përkatëse për vitin 2020.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Bashkëpunimi ndërkombëtar përbën një mjet të rëndësishëm për forcimin e të kuptuarit të lidhjes në mes të subjekteve të ndryshme ndërkombëtare të cilat i lidh interesi dhe synimi i përbashkët, dhe siguron kornizën për zbatimin e parimeve të këtij bashkëpunimi në praktikë.

AKK e vlerëson lartë dhe është i përkushtuar për realizimin sa më të suksesshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar sepse është i vetëdijshëm se bashkëpunimi ndërkombëtar promovon zhvillimin e ndërsjellë, dialogun dhe shkëmbimin e të dhënave dhe njohurive, që nga ana tjetër e përparon zbatimin dhe funksionalizimin e nexus parimeve.

Për shkak të dominimit të rrethanave të pandemisë, dhe kufizimit të lëvizjeve gjatë vitit 2020, bashkëpunimi ndërkombëtar është zhvilluar kryesisht nëpërmjet të pjesëmarrjes dhe qëndrimeve proaktive të eksperteve të AKK-së në seminarët dhe komunikimet e tjera on-line me subjektet ndërkombëtare, të cilat përkujdesen për zbatimin sa më të përpiktë të standardeve të konkurrencës në tregjet përkatëse.

 Regional Centre for Competition in Budapest (Hungary)	 International Competition Network	 BETTER POLICIES FOR BETTER LIVES
 Turkish Competition Authority REKABET KURUMU	 The Vienna Institute for International Economic Studies	

Këto takime dhe seminare janë të paraqitura ne pasqyrën e mëposhtme.

PËRFAQËSIMET, ANKESAT DHE KËRKESAT NË GJYKATA

Përfaqësime, përgjigje në padi, aktgjykime, ankesa

	2018	2019	2020	2021
Përfaqësime në Gjykatën Themelore të Prishtinës	11	/	1	2
Përgjigje në padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës	/	1	1	1
Aktgjykime nga Gjykata Themelore e Prishtinës	1	/	/	1
Ankesa në Gjykatën e Apelit të Kosovës	5	1	/	1
Aktgjykime nga Gjykata e Apelit të Kosovës	2	4	/	1
Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës	3	3	/	/
Aktgjykime nga Gjykata Supreme e Kosovës	1	4	2	/

Sqarime për rastet e paraqitura ne tabelën për vitin 2021:

- Përfaqësim në DÇA-GJTH të Prishtinës, në konfliktin administrativ për anulimin e Aktit administrativ – Konkluzion nr. 92/18-02/D i datës 27.02.2018 (“Doni”, “Dardania”, “Kurora”, “Loti”, “Piramida”, “Ruhani” dhe “Kujtimi” kundër të paditurave Komuna e Prishtinës, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës dhe Këshilli i Bashkësisë Islame në Prishtinë).
- Përfaqësim në DÇA-GJTH të Prishtinës, për lëndën A.nr 2016/2016 “Posta e Kosovës” kundër Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe palëve të interesit “Moneta”, “Vllesa Co” dhe “Prepaid”.
- Aktgjykimi nga DÇA-GJTH të Prishtinës, për konfliktin administrativ të paditësve “Doni”, “Dardania”, “Kurora”, “Loti”, “Piramida”, “Ruhani” dhe “Kujtimi” kundër të paditurave Komuna e Prishtinës, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës dhe Këshilli i Bashkësisë Islame në Prishtinë.
- Dorëzimi i Ankesës në DÇA-GJTH të Prishtinës për Gjykatën e Apelit të Kosovës për rastin, “Doni”, “Dardania”, “Kurora”, “Loti”, “Piramida”, “Ruhani” dhe “Kujtimi” kundër të paditurave Komuna e Prishtinës, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës dhe Këshilli i Bashkësisë Islame në Prishtinë.
- Pranimi i Kërkesës për Rishqyrtim të Jashtëzakonshëm nga “Posta e Kosovës” të bërë në DÇA-GJTH të Prishtinës, për Gjykatën Supreme të Kosovës, për anulimin e Vendimit të paditurës Autoriteti Kosovar i Konkurrencës.
- Aktvendimi i DÇA-GJTH të Prishtinës, aktpadia e “Telekomi i Kosovës” kundër Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

TRAJNIMET E BRENDSHME, VIZITAT JASHTË SHTETIT, KONFERENCAT DHE SEMINARET ON-LINE

Në funksion të ngritjes profesionale të zyrtarëve të AKK-së dhe zbatimit të planit të mbështetjes edhe të Institucioneve tjera, janë mbajtur trajnime, seminare dhe punëtori, të mbështetur nga Institucione vendore (IKAP, MFPT, etj.) dhe ekspert të angazhuar nga projekti që mbështet AKK-në. Një përmbledhje informuese për këto angazhime është në tabelat më poshtë:

Tab. 1. Trajnimet në fushën e Administratës publike

Nr.	Institucioni nikoqir	Vendi	Koha dhe Tema – Qëllimi
1	IKAP	Webinar/zoom	<u>20-21 Janar 2021</u> “Ligji Evropian i Pronës Intelektuale: Projektimet dhe Markat Tregtare”
2	AKK – Punëtori/ work shoop	Prizren-Prevallë	<u>10 – 12 Mars 2021</u> ✚ Raporti i Punës 2020, ✚ Përpunimi i tabelës së rasteve për vitin 2020 dhe 2021, ✚ Rishikimi i kërkesave të Planit të punës për vitin 2021
3	Ministria e Financave	Prishtinë	<u>10 - 12 Mars 2021</u> Pamje në raportet e SIMFK
4	Ministria e Financave	Prishtinë	<u>13 Mars 2021</u> Zyrtar i shpenzimeve
5	IKAP/KRPP	On-line	<u>22, 23 dhe 26 Prill 2021</u> Moduli për Urdhër- Blerje
6	Ministria e Financave	Prishtinë	<u>30.04 dhe 5-7 Maj 2021</u> “Moduli i të Hyrave”
7	Ministria e Financave	Prishtinë	<u>27 Maj 2021</u> Zyrtar i shpenzimeve

8	IKAP	Qendra e trajnimeve-Prishtine	01-02 Qershor 2021 Sistemi i zhvillimit dhe menaxhimit te buxhetit BDMS
9	IKAP	On-line	07-08 Qershor 2021 Zyrtar për pranimin e mallit
10	IKAP	Webinar/zoom	21-23 Qershor 2021 Kudri ligjor dhe teknikat për harmonizimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së.
11	Departamenti për ndihme shtetërore	Ujëvara Drinit, Radac, Pejë	6 – 7 Dhjetor 2021 Draft Rregullore QRK-Nr. xx-2021, Kushtet për dhënien e ndihmës shtetërore horizontale
12	IKAP ne bashkëpunim me Kombet e Bashkuara dhe UN Women	“Villa Gërmia” Prishtinë	17 Dhjetor 2021 Adresimi i diskriminimit gjinor në vendin e punës

Tabela 2. Trajnimet, seminarët dhe punëtoritë ne fushën e konkurrencës

Nr.	Organizatori	Platforma	Koha / Temat dhe qëllimi
1	BS-Europe	Webinar/zoom	2 Shkurt 2021 “Marrëveshjet e ndaluara” (Parimet dhe qasjet kryesore në lidhje me legjislacionin e BE dhe të Kosovës për marrëveshjet e ndaluara, Marrëveshjet e përjashtuara, Kartelet) (implementuar nga Dr. Eugene Stuart, Z. Elonas Satas, Z. Daniel Colgan and Z. Pajtim Melani).
2	B&S – Europe	Webinar/zoom	9 Shkurt 2021

			“Pozitat dominuese dhe abuzimet e dominimit” (Parimet dhe qasjet kryesore në lidhje me legjislacionin e BE-së dhe të Kosovës mbi pozicionet dominuese Abuzimet e dominimit) (implementuar nga, Z. Elonas Satas, Z. Daniel Colgan dhe Z. Pajtim Melani)
3	B&S – Europe	Webinar/zoom	16 Shkurt 2021 “Kontrolli i përqendrimeve” (Parimet dhe qasjet kryesore në lidhje me BE, Legjislacioni i Kosovës dhe shteteve anëtare të BE-së për kontrollin e përqendrimeve; përfshirë llojet e përqendrimit dhe ndikimet e tyre në konkurrencë. (implementuar nga, Z. Elonas Satas, Z. Daniel Colgan and Z. Pajtim Melani).
4	B&S – Europe	Webinar/zoom	18 – 21 Shkurt 2021 “Hulumtimi i Tregut – Market Survey” Organizuar nga LUX –Development me ekspertin nga Austria znj. Sarah Furlinger me temën Hulumtimi i tregut (Market Survey), Hulumtimi tregut ne Austri, Rastet Amazona, Taxi dhe BGO Holding si dhe prezantimi i rasteve ne grupe.
5	B&S – Europe	Webinar/zoom	23 Shkurt 2021 “Sigurimi i konkurrencës në sektorë të rregulluar” (Parimet dhe qasjet kryesore dhe praktikat më të mira ndërkombëtare) (implementuar nga, Z. Elonas Satas, Z. Daniel Colgan and Z. Pajtim Melani).
6	RCC Seminar	Virtual	2-4 Mars 2021

			Tackling Bid Rigging in Public Procurement/Trajtimi i manipulimit te Ofertave ne prokurimin publik
7	Tryezë e rumbullaket (me mbështetjen e Projektit te BE-se)	Prishtine (Hotel International Prishtina)	18 Mars 2021 Aspektet procedurale të hetimit të shkeljeve të konkurrencës
8	Komisioni European	Webinar/zoom	18 Maj 2021 “SEE Competitiveness Outlook 2021: Presentation of preliminary Findings-Kosovo/SEE- Perspektivat-pikëpamjet e 2021, Prezantimi i te gjeturave preliminare – Kosovë
9	RCC Seminar	Webinar/zoom	18-19 Maj 2021 A Key Driver for Competition Advocacy and Enforcement/ Udheheqesit kryesor për avokimin dhe zbatimin e Konkurrencës.
10	B&S – Europe dhe zyrtarët e BQK (Banka Qendrore e Kosovës)	Webinar/zoom	1 Qershor 2021 “Politikat dhe zbatimi i konkurrencës ne sektorin e shërbimeve bankare dhe financiare” - Marrëveshjet e ndaluara, - Abuzimi me pozitën dominuese, - Përqendrimet, - Kontrolli i bashkimit në sektorin bankar, - Bashkimi horizontal, - Bashkimi vertikal
11	B&S–Europe Tryeze e përbashkët AKK – BQK	Webinar/zoom	2 Qershor 2021 Tryeze e përbashkët AKK – BQK “Politikat dhe zbatimi i konkurrencës ne sektorin e

	(Banka Qendrore e Kosovës)		shërbimeve bankare dhe financiare” - Zbatimi i rregullave të konkurrencës në sektorin e sigurimeve, - Rregullorja e BE-së 267/2010 dhe marrëveshjet horizontale në sektorin e sigurimeve, - Vendosja e tregjeve përkatëse dhe dominimi I tregut në përqendrimet e sigurimeve - Diskutim i përgjithshëm mbi çështjet bankare dhe të sigurimeve në Kosovë dhe bashkëpunimi i AKK-së me BQK-në.
12	B&S – Europe	Hotel International Prishtina	15 – 16 Shtator 2021 "Pozitat dominuese në treg dhe keqpërdorimi i dominimit"
13	B&S – Europe	Hotel International Prishtina	22 – 23 Shtator 2021 "Kontrolli i përqendrimeve"
14	B&S – Europe	Webinar/zoom	29 shtator 2021 Struktura organizative për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës (Faza1) Tryezë e rumbullakët
15	B&S – Europe	Webinar/zoom Hotel International Prishtina	06-07 Tetor "Marrëveshjet e ndaluara dhe ndjekja e kartelevë të forta" Mbajtur nga Prof. Dr. Michael Saller
16	B&S – Europe	Hotel International Prishtina	2 – 3 Dhjetor 2021 Trajnim/seminar me ARKEP-in, “Ligji dhe politikat e konkurrencës ne sektorin e telekomunikimeve”
17	RCC Seminar	Webinar/zoom	09-10 Dhjetor

			“Carrying out Effective Antitrust Investigations” (Zbatimi/ndërmarrja e hetimeve efektive ne konkurrence)
18	B&S – Europe	Hotel International Prishtina	<u>9-10 Dhjetor 2021</u> Trajnim-Seminar me ZRRE-në, “Ligji i konkurrencës” dhe “Politikat në sektorin e energjisë”
19	B&S – Europe	Hotel International Prishtina	<u>20-21 Dhjetor 2021</u> <u>Trajnim-Seminar me Gjyqësorin</u> “Ndalimi i marrëveshjeve kundër konkurrencës dhe lufta kundër kartelit në praktikë”

RAPORTI FINANCIAR

Financimi i Autoritetit sigurohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Shpenzimet për funksionimin e AKK-së janë të përcaktuara sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve. Të hyrat që krijohen nga aktivitetet e AKK-së nuk mund të parashikohen, por janë në rritje të vazhdueshme dhe gjithnjë derdhen në Buxhetin e Kosovës.

Kapacitetet njerëzore të **AKK-se** janë mjaft të kufizuara dhe ristrukturimet për menaxhim më të mirë janë gjithashtu të kufizuara, edhe nga fakti i zvogëlimit të numrit të paraparë të zyrtarëve në raport me vitin 2019, ka një zvogëlim të parashikuar të numrit të zyrtarëve (*krahasimet e tabelave më poshtë*), sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2021-2023.

Tab.1. Buxheti për vitet 2021 – 2023

Nr.	Përshkrimi	Buxheti 2021	Buxheti 2022	Buxheti 2023
1	Nr. te punësuarve	24	24	24
2	Paga dhe mëditje	270.627,00	270.316,00	271.668,00
3	Mallra dhe shërbime	60.181,00	60.680,00	65.000,00
4	Shpenzimet komunale	14.000,00	14.000,00	14.000,00
5	Investimet kapitale	0,00	0,00	0,00
	Gjithsej	344.808,00	344.996,00	350.668,00

Tab.2. Buxheti për vitet e kaluara 2018 – 2020

Nr.	Përshkrimi	Buxheti 2018	Buxheti 2019	Buxheti 2020
1	Nr. te punësuarve	25	26	24
2	Paga dhe mëditje	259.548,00	272.846,00	269.282,00
3	Mallra dhe shërbime	59.861,00	66.861,00	63.518,00
4	Shpenzimet komunale	13.000,00	14.000,00	14.000,00
5	Investimet kapitale	0,00	0,00	0,00
	Gjithsej	332.409,00	353.707,00	346.800,00

Raportimi financiar është sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme dhe përmbushë të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe nga Ligjet Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194, Nr. 05/L-007 dhe Ligji Nr. 05/L-063.

Të dhënat janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur. Zhvillimet buxhetore të AKK-së në vitin 2021, ishin si në vijim:

Buxheti i lejuar dhe i shpenzuar sipas kategorive:

Nr.	Kategoria	Buxheti i lejuar	Buxheti i shpenzuar	Përqindja e shpenzuar
1.	Paga dhe mëditje	201,031.70	201,031.70	100.00 %
2.	Mallra dhe Shërbime	43,104.15	42,418.65	98.40 %
3.	Shpenzime Komunale	975.15	914.65	93.79 %
	Gjithsej:	245,111.00	244,365.00	99.69 %

Raporti financiar i AKK-së për vitin 2021, në mënyrë të detajuar është i bashkangjitur me këtë raport.

RAPORTI VJETOR DHE REKOMANDIMET E ZKA

Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Autoritetin Kosovar të konkurrencës për vitin 2020, është Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore. Paragrafët e këtij opinionit janë të shkëputura më poshtë:

Opinion i auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK) të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, në bazë të Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare për vitin 2020 nga Zyra Kombëtare e Auditimit, nuk kishte asnjë të gjetur.

Nr.	Çështja, E gjetura, Ndikimi, Rekomandimi	Veprimi i menaxhmentit	Data e planifikuar e përfundimit	Personi përgjegjës
/	/	/	/	/

SFIDAT DHE REKOMANDIMET E INSTITUCIONIT

a. Sfidat e AKK

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, gjatë ushtrimit të detyrave të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, vazhdon të jetë i ballafaquar me sfida si të aspektit teknik, organizativ e funksional, siç janë:

1. Ligji 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës është ndryshuar me plotësim ndryshimin nr. 04/L-226 ndërsa sfidë në vete mbetet që Ligji të ndryshohet në tërësi duke e harmonizuar me Direktivat e BE-së,
2. Statuti i Autoritetit duhet të harmonizohet me Ligjin në fuqi,
3. Trajnimi i gjyqtarëve, për një njohje sa më të plotë dhe adekuate të veçorive të ligjit të konkurrencës, si dhe të së drejtës europiane në këtë fushë, me synim arsyetimin e vendimeve të tyre, bazuar në një vlerësim real të konkurrencës, si një e mirë publike.
4. Avokimi me bizneset e mëdha, të mesme dhe të vogla.
5. Avokim me mediat të cilat janë një faktor shumë i rëndësishëm.
6. Ngritjen e kapaciteteve (trajnimi) të stafit në përgjithësi.
7. Monitorimi dhe fillimi i procedurave për shkelësit e Konkurrencës (sipas detyrës zyrtare) ex officio.
8. Sfidë e Autoritetit mbetet kontrollat e paparalajmeruar ndaj ndërmarrjeve dhe konfiskimi i fakteve.
9. Sfidë e Autoritetit gjithashtu mbetet promovimi i programit të lehtësirave nga ndërmarrjet.

b. Rekomandimet e Autoritetit për vitin 2022

Në përputhje me objektivat strategjike dhe operacionale të përcaktuara për vitin 2022 dhe në përputhje me dispozitat e pikës së dhjetë të parë të nenit 28 të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, si dhe të pikës së parë të paragrafit të dytë të nenit 12 të Statutit, Autoriteti rekomandon si prioritet të politikës së konkurrencës për vitin 2020, këto aktivitete:

1. Harmonizimi i mëtutjeshëm i akteve nënligjore me direktivat evropiane.
2. Krijimi i një baze të të dhënave, përmes të cilës do të bëjmë grumbullimin e të dhënave dhe ruajtjen e tyre,
3. Përgatitja e broshurave promovuese për politikën dhe përfitimet që vijnë nga konkurrenca dhe rritjen e kulturës së konkurrencës,
4. Bashkëpunimi me rregullatorët të tregjeve publiko private dhe Instiucionet publike,
5. Monitorimi i sjelljes së ndërmarrjeve që iu janë dhënë të drejta të veçanta/ekskluzive nga shteti si dhe ofrimi i rekomandimeve përkatëse, rast pas rasti,
6. Fuqizimi i mëtejshëm i kapaciteteve profesionale dhe administrative, përmes trajnimeve, me qëllim ngritjen e ekspertizës për hetime dhe analiza të thelluara ekonomike, për të identifikuar sjelljen e ndërmarrjeve në treg,
7. Fokusi i punës së Autoritetit mbetet monitorimi, analizimi, hetimi dhe propozimi i masave dhe rekomandimeve konkrete për zhvillimin e konkurrencës së drejtë.

Politika e konkurrencës është një element i domosdoshëm i një tregu të lirë, që funksionon duke siguruar që të gjitha ndërmarrjet konkurrojnë në mënyrë të barabartë dhe të drejtë në bazë të meritave të tyre. Synimi i Autoritetit është që të arrij të promovoj dhe zbatoj rregullat e konkurrencës, që të sigurojnë konkurrencën e drejtë në mes të operatorëve në treg dhe interesave të autoriteteve tjera publike.

SHTOJCAT

ORGANOGRAMI I AKK-së

